

VENDIM
Nr.310, datë 5.5.2010

PËR MËNYRËN DHE LLOGARITJEN E AFATEVE TË PAGIMIT TË ÇMIMIT TË TRUALLIT, PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË MBI TRUALLIN SHTETËROR, NË ZONAT ME PËRPARËSI TURIZMIN

(Ndryshuar me VKM nr. 475, datë 3.6.2015)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 10 të ligjit nr.10 186, datë 5.11.2009 “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Çmimi i truallit të njësisë së ndërtuar brenda zonës së stimuluar përcaktohet në bazë të hartës së vlerës së tokës. Shlyerja e çmimit të truallit nga subjekti i interesuar apo personi i stimuluar bëhet pas njoftimit me shkrim nga Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), në të cilin është përcaktuar vlera e çmimit, që do të paguhet.

2. Pagesa e plotë apo e pjesës takuese të çmimit të truallit të njësisë së ndërtuar nga subjekti i interesuar/personi i stimuluar bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e marrjes së njoftimit.

3. Çmimi i truallit të njësisë së ndërtuar apo vlera e pjesës takuese paguhet në mënyrë të vetme, duke u reduktuar në masën 10 (dhjetë) për qind, nëse pagesa kryhet brenda 1 (një) muaji, nga njoftimi me shkrim, në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 10186, datë 5.11.2009, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, të ndryshuar.

4. Nëse pagesa e plotë apo e pjesës takuese të çmimit të truallit nuk kryhet brenda afatit të parashikuar në pikën 2, të këtij vendimi, në zbatim të pikës 2, të nenit 16, të ligjit nr. 10186, datë 5.11.2009, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, të ndryshuar, mbi vlerën e detyrimit llogaritet penaltet në masën 10 (dhjetë) për qind të çmimit total të truallit ose pjesës takuese, për çdo muaj vonesë, me kusht që masa e penaltetit të mos e kalojë këtë çmim, apo vlerën e pjesës takuese, sipas rastit.

5. Subjekti i interesuar/personi i stimuluar dorëzon dokumentacionin financiar që vërteton kryerjen e pagesës, pranë ALUIZNI-t, i cili e administron atë në dosjen përkatëse të subjektit. Kur subjekti i interesuar/personi i stimuluar ka paguar të gjithë vlerën e çmimit të truallit apo pjesën takuese të tij, vijohet me lidhjen e kontratës së kalimit të së drejtës së pronësisë mbi truallin.

6. *Shfuqizuar.*

7. Për njësitë e ndërtuara që gëzohen nga dy ose më shumë subjekte të interesuara/persona të stimuluar, në rastet kur njëri prej tyre ka paguar pjesën takuese të çmimit të truallit, ky i fundit ka të drejtë të lidhë kontratën e kalimit të së drejtës së pronësisë, pavarësisht nëse bashkëpronari tjetër nuk ka paguar pjesën e tij, takuese, të çmimit të truallit.

8. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Beris

